



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:087667

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06112205

PAKR.nr.205/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Xhevdet Abazi, me bashkëpunëtorin profesional Endrit Ajeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve, M.B., nga Vushtrria, për shkak të veprës penale shtytje në tentim vrasje të rëndë, nga neni 147 par.10 dhe 11 e lidhur me nenin 20 dhe 24 të KPK, dhe A.B., nga Mitrovica, J.O. dhe A.O., që të dy nga Vushtrria, për shkak të veprës penale vrasje e rënd në tentativë, nga neni 147 par.10 dhe 11, e lidhur me nenin 20 e 23 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe përgjigjeve në ankesën e prokurorisë, të paraqitur nga ana e mbrojtësve së të akuzuarve, M.B., av.Mahmut Halimi dhe A.O., av.Kada Bunjaku Përçuku, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.140/2008, të dt.09.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.04.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.140/2008, të dt.09.02.2024, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.140/2008, të dt.09.02.2024, i akuzuari M.B., në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, është liruar nga akuza për veprën penale shtytje në tentim vrasje të rëndë nga neni 147 par.10 dhe 11 e lidhur me nenin 20 dhe nenin 24 të KPK, pasi që nuk është provuar se ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Po ashtu të akuzuarit, A.B., J.O. dhe A.O., në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, janë liruar nga akuza, për veprën penale vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 pika 10 dhe 11 e lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK, pasi që nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Palët e dëmtuara, D.A., B.B dhe R.I., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.140/2008, të dt.09.02.2024, të ndryshohet dhe të akuzuarit të shpallen fajtor për veprat penale sikurse në aktakuzë, të dënohen sipas ligjit, ose çështjen penale t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

-Përgjigje në ankesë të prokurorisë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit M.B.t, av.Mahmut Halimi, dhe ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.140/2008, të dt.09.02.2024, të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

-Përgjigje në ankesë të prokurorisë ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit A.O., av.Kada Bunjaku Përçuku, dhe ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.140/2008, të dt.09.02.2024, të refuzohet si e pa bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.194/2024, të datës 28.03.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit të shpallen fajtor për veprat penale të cilat u vihen në barrë, ose që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e rivendosje.

Sa i përket përgjigjeve në ankesë të prokurorisë dhe atë të mbrojtësit së të akuzuarit M.B.t, av.Mahmut Halimi, dhe mbrojtësit së të akuzuarit A.O., av.Kada Bunjaku Përçuku, të njëjtat të refuzohen si të pabazuara.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, në kuptim të nenit 390 të KPPK, ka caktuar seancën e kolegjit për datën 04.07.2024. dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit ka prezantuar i dëmtuari R.I., mbrojtësit e të akuzuarve M.B., av.Mahmut Halimi, A.B., av. Berat Peci dhe J.O., av.Xhafer Maliqi.

Nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit, të akuzuarit M.B., A.B., J.O. dhe A.O., të dëmtuarit D.A. dhe B.B, si dhe mbrojtësja e të akuzuarit A.O., av.Kada Bunjaku Përçuku, përkundër asaj që janë njoftimet me rregull, me të cilën vërtetohet nga shkresat e lëndës.

I dëmtuari R.I., deklaroi se e përkrah në tërësi ankesën e parashtruar nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk ka çka të shtoj më shumë.

Mbrojtësi i të akuzuarit M.B., av.Mahmut Halimi, ka deklaruar se mbetet në tërësi panë përgjigjes në ankesë të ushtruar, duke shtuar se me asnjë provë, nga shkresat e lëndës, nuk është vetëtuar se i akuzuari M.B., ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj propozon që vendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të vërtetohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B., av.Berat Peci, ka deklaruar se vendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, është i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj propozon që i njëjti të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar e në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit lirues, kundër të akuzuarit M.B., ka konstatuar se nuk janë përmbushur elementet e veprës penale shtytje në tentim vrasje të rëndë, nga neni 147 pika 10 dhe 11 lidhur me nenin 20 e 24 të KPK, duke pretenduar se nga provat e administruara, sikurse provat personale, po ashtu edhe ato materiale nuk ka mundur që të vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit M.B., janë formuluar elementet e veprës penale, për të cilën ka qenë i akuzuar, e po ashtu edhe për të akuzuarit A.B., J.O., dhe A.O., kinse nuk janë formuluar elementet qenësore të veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, nga neni 147 pika 10 dhe 11 lidhur me nenin 23 të KPK.

Po qesë vlerësohen që të gjitha provat të cilat janë proceduar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, atëherë me siguri do të vije deri te përfundimi se në veprimet e secilit të akuzuarit, janë formuluar elemente qenësore të veprës penale e cila i vihet në barrë, ashtu që lirimi i të njëjtëve nga akuza, nuk është bërë konform ligjit.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara, të parapara në kuptim të nenit 384 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, është i qartë, i kuptueshëm në harmoni me vetveten si dhe arsyet e dhëna për secilën pikë të aktgjykimit, që nënkupton se përmban arsyet lidhur me faktet vendimtare të cilat, arsyetojnë se aktgjykimi lirues i nxjerrë në këtë çështje penale, në drejtim të të akuzuarit M.B., për shkak të veprës penale shtytja në tentim vrasje të rëndë, nga neni 147 par.10 dhe 11 dhe lidhur me nenin 20 e 24 të KPK, si dhe të akuzuarit A.B., J.O., dhe A.O., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 par.10 dhe 11 dhe lidhur me nenin 20 e 23 të KPK, është vendimi drejtë, i mbështetur në ligj, sepse pasi që ka vlerësuar të gjitha provat personale, po ashtu edhe ato materiale nga shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim që të akuzuarit i ka liruar nga akuza në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPK.

Po ashtu kolegji ka vlerësuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat ndërliken me nenin 384 par.2 pika 2.7 lidhur me nenin 369 të KPK, sepse ka respektuar dispozitat ligjore, duke përmbajtur formën e aktgjykimit me shkrim, pasi që i njëjti është shpallur sepse aktgjykimi përmban të gjitha

pjesët që duhet ti përmban i njëjti, se në dispozitiv të aktgjykimit janë përfshirë të gjitha të dhënat personale për secilin të akuzuar dhe në mënyrë të qartë janë dhënë arsyet se pse të njëjtit i ka liruar nga akuza, e po ashtu në arsyetim të aktgjykimit, ka dhënë arsye për çdo pikë të aktgjykimit dhe ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara, si dhe në mënyrë të qartë ka vlerësuar se saktësia e provave në këtë çështje penale është potencuar në aktgjykim për të gjitha çështjet e ngritura nga secila palë, andaj aktgjykimi i nxjerr e ka mbështetjen e duhur ligjore.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke shtuar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë është dashur që ti vlerësoj në mënyrë më përmbajtësore deklaratat e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve, sikurse janë të dëmtuarit R.I., D.A. dhe B.I., e po ashtu edhe dëshmitarët Sh.B., M.P., F.C., F.M., J.A, H.H. policët M.O., Sh.H., për të vërtetuar se në veprimet e secilit të akuzuar është formuluar elementi e qenësor i veprës penale e cila i vihet në barrë, pasi që nga kjo çështje penale janë thënë edhe fjalët kërcënuese “do t’ju vras, do t’ju bëjë nënën kështu dhe ashtu, dhe do t’ju vras familjen”, që rezulton se të njëjtat kanë qenë fjalë kërcënuese, andaj gjykata e shkallës së parë këto fakte nuk i ka vërtetuar që në nënkupton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ka ngel i mangët sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me pretendimet ankimore nga ana e prokurorisë, sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, apo mos vërtetimit të së njëjtës dhe ka ardhur në përfundim se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të qatë është vlerësuar çdo provë nga shkresat e lëndës dhe e njëjta drejte ka vendosur kur të akuzuarin M.B., e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale shtytje në tentim vrasje të rëndë nga neni 147 par.10 dhe 11 lidhur me nenin 20 e 24 të KPK, dhe të akuzuarit, A.B., J.O. dhe A.O., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par.10 dhe 11 e lidhur me nenin 20 e 23 të KPK. Nga ana e gjykatës së shkallës së parë se janë vlerësuar në masë të duhur të gjitha provat në masë të duhur, rezulton nga vlerësimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, kur rezulton se janë dëgjuar të dëmtuarit R.I. D.A. dhe B.B, ashtu që asnjëra deklaratë e asnjërit prej tyre nuk mund të vërtetohet ndonjë veprim inkriminues i ndonjë të akuzuari, sepse i dëmtuari R.I., ka deklaruar se nuk ka pasur kontakte me asnjërin nga të akuzuarit, se i dëmtuari D.A., ka deklaruar se nuk është goditur me makinë nga ana e askujt, se i dëmtuari B.B, nuk e ka njohur vozitësin e automjetit “BMW”, se nuk jemi goditur nga askush dhe se nuk është lënduar asnjëri nga ta.

Po ashtu edhe nga vlerësimi i deklaratave të dëshmitarëve F.M., M.O., Sh.B., J.A., Sh.H., H.H., A.B., B.T., nga asnjëri, nga këto dëshmi nuk vërtetohet se në veprimet e ndonjërit nga të akuzuarit, janë kryer veprat penale të cilat u vihen në barrë të akuzuarve, sikurse nuk mund të vërtetohet edhe nga ana e dëshmitarëve F.C. dhe M.P..

Në këtë çështje penale rezulton se nuk ka as prova materiale me të cilat do të vërtetohen se me veprimet e ndonjërit nga të akuzuarit janë formuluar elementet inkriminuese të veprës penale e cila i vihet në barrë, andaj gjykata e shkallës së parë, pasi që ka proceduar me të gjitha provat personale dhe materiale, ka vërtetuar se në veprimet e asnjërit prej tyre nuk është formuluar ndonjëri elementet inkriminues të veprës penale e cila i vihet në barrë ndonjërit nga të akuzuarit, ashtu që në mungesë të të gjitha provave, e edhe pas vlerësimit të deklaratave të secilit të akuzuar ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale duhet të nxirret aktgjykim lirues, në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 i KPPK, pasi që nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale, e cila u vihet në barrë.

Nga ankesa e prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallë së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve të ligjit penal, duke theksuar se në këtë çështje penale përkundër asaj që gjykata e shkallës së parë, pasi që ka proceduar provat nga shkresat e lëndës, duke dëgjuar të akuzuarit, të dëmtuarit, dëshmitarët, parashtrohet pyetja se në prani të të gjitha këtyre provave, si nuk është mundur që të vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit M.B., janë formuluar elementet e veprës penale shtytje në tentim vrasje të rëndë, nga neni 147 par.10 dhe 11, lidhur me nenin 20 e 24 të KPK, dhe të akuzuarit A.B., J.O., dhe A.O., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 par.10 dhe 11 lidhur me nenin 20 e 23 të KPK.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, përkritazi me shkeljet e ligjit penal, të paraparë në nenin 385 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale me të gjitha provat nga shkresat e lëndës, të cilat janë procedura gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe janë vlerësuar, nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit M.B., janë formuluar elementet e veprës penale shtytje në tentim vrasje të rëndë, nga neni 147 par.10 dhe 11, lidhur me neni 20 e 24 të KPK, si dhe në veprimet e të akuzuarve, A.B., J.O. dhe A.O., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë, nga neni 147 par.10 dhe 11, lidhur me nenin 20 e 23 të KPK, andaj në këtë drejtim drejt është vendosur kur të njëjtit i ka liruar nga akuza, në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, pasi që nuk është provuar se në veprimet e asnjërit prej tyre, është kryer vepra penale e cila i vihet në barrë.

Po ashtu kolegji ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza, ngase rrethanat pas vërtetimit të fakteve kanë qar në drejtim të asaj që secilin të akuzuar e ka përjashtuar nga ndjekja penale si dhe përgjegjësia penale, andaj edhe drejt është vendosur kur secili i akuzuar është liruar nga akuza.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.205/2024, të datës 04.07.2024

Procesmbajtës,
Endrit Ajeti

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetare e kolegjit,
Kadrije Goga Lubishtani

Xhevdet Abazi